

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**P R E S I D E N T I**

**D E K R E T**

**Nr. 1510 date 28.06.1996**

**PER**

**NJE NDRYSHIM NE LIGJIN NR. 7928, DATE 27.04.1995, NDRYSHUAR ME LIGJIN  
NR. 8070, DATE 15.02.1996 "PER TATIMIN MBI VLEREN E SHTUAR"**

Ne mbeshtetje te nenit 28, pika 19, te ligjit Nr. 7491, date 29.04.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**D e k r e t o j :**

**Neni 1**

Neni 19 ndryshohet si vijon :

- "1. Furnizimi eshte nje furnizim i perjashtuar, nese ai percaktohet ne nenet 20 deri ne 25 dhe ne nenet 25/1, 25/2 26/1 e 26/2.
2. Ministri i Financave ka te drejte te caktoj me udhezim se cili prej furnizimeve te perjashtuara nga nenet 20 deri ne 25 dhe ne nenet 25/1, 25/2 26/1 e 26/2 te ketij ligji nuk eshte nje furnizim i perjashtuar ne kushte e rrethana te percaktuara".

**Neni 2**

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me kete permbajtje:

- a) Furnizimi i sherbimeve qe kryhen nga kontraktoret e nenkontraktoret e tyre, vertetuar si te tille nga Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve, lidhur me realizimin e fazave te kerkimit dhe zhvillimit te operacioneve hidrokarbure.
- b) Furnizimi i mallrave qe bejne kontraktoret per njeri-tjetrin ose nenkontraktoret per kontraktoret e tyre, te importuara sipas nenit 26/1 te ketij ligji.

"Operacionet Hidrokarbure", per efekt te ketij paragrafi, ka te njejtin kuptim si ne ligjin Nr. 7746, date 28.07.1993 "Per hidrokarburet".

**Neni 3**

Pas nenit 25/1 shtohet neni 25/2 me kete permbajtje:

"Furnizimi i grurit, i miellit per buke masive, si dhe i gazit te lenget per ngrohje per popullsine, jane furnizime te perjasuara".

#### **Neni 4**

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me kete permbajtje :

Eshte furnizim i perjashtuar nga TVSH:

Importimi perfundimtar i te gjitha mallrave prej nje personi te tatueshem, kur furnizimi i tyre ne te gjitha rrethanat brenda vendit eshte nje furnizimi i perjashtuar nga tatimi mbi vleren e shtuar.

Importimi i mallrave te vendosura ne regjimin e tranzitit.

Importimi i mallrave te deklaruar per te qene nen regjimin e lejimit te perkoheshem dhe ate te perpunimit aktiv.

Importimi i mallrave dhe i sherbimeve qe lidhen me realizimin e fazave te kerkimit dhe te zhvillimit te operacioneve hidrokarbure, te kryera nga kontraktoret ose nenkontraktoret qe punojne per keto operacione. Kontraktoret dhe nenkontraktoret vertetohen si te tille nga Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve.

"Operacionet Hidrokarbure", per efekt te ketij paragrafi, ka te njejtin kuptim si ne ligjin Nr. 7746, date 28.07.1993 "Per hidrokarburet".

#### **Neni 5**

Pas nenit 26/1 shtohet neni 26/2 me kete permbajtje:

Eshte furnizimi i perjashtuar nga TVSH:

- Importimi i grurit dhe i miellit per buke masive per popullsine;
- Importimi i vajgurit dhe i gazit te lenget per popullsine.

#### **Neni 6**

Perjashtimet e parashikuara sipas neneve 25/2 dhe 26/2 shfuqizohen me liberalizimin e cmimeve te shitjes se ketyre mallrave.

#### **Neni 7**

Ky dekret hyn ne fuqi me 01.07.1996

KUNDERFIRMOHET

KRYETARI I KESHILLI TE MINISTRAVE

PRESIDENTI I REPUBLIKES

Aleksander MEKSI

Sali BERISHA